



Shoqata Përtej Barrierave

Thirrje për Ekspert

për trajnimin e Anëtarëve të Këshillit Rinor në fushën e Lidershit, Avokimit dhe Simulimit të Politikave.

Termet e Referencës

Përtej Barrierave është një organizatë jofitimprurëse e shoqërisë civile, e themeluar në vitin 2004. Ne punojmë me të rinjtë në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian, duke promovuar përfshirjen dhe ngritjen e kapaciteteve përmes edukimit joformal. Përtej Barrierave është Pika e Kontaktit e programeve Erasmus+ YiA dhe European Solidarity Corps të Komisionit Evropian, për Shqipërinë.

Mbi Projektin

Voice & Impact fokusohet në rritjen e njohurive, aftësive dhe kompetencave të anëtarëve të këshillit rinor në bashkitë Maliq, Sarandë, Tepelenë dhe Gjirokastrë për të mundur pjesëmarrje efektive në qeverisjen vendore dhe advokimin. Në kuadër të këtij projekti, do të organizohen tre aktivitete kyçe: **Trajnim për Lidership, Trajnim për Avokim dhe ACTive Bootcamp për zhvillimin e aftësive dhe kompetencave të anëtarëve të këshillave rinorë në analizën e politikave, komunikimin, avokimin dhe negociimin.**

1. **Trajnimi dy-ditor për Leadershipin** do të përbëhet nga 6 seminare të për të ndërtuar kapacitetet e anëtarëve të këshillit rinor në katër bashki. Trajnimi do të mbulojë tema të tilla si analiza e politikave, strategjitë kombëtare dhe evropiane për rininë, lidershipi dhe të folurit në publik.

2. **Trajnim dy-ditor për Avokim** do të përfshijë gjashtë seminare të fokusuar në strategjitë e avokimit dhe komunikimin efektiv. Pjesëmarrësit do të trajnohen nepërmjet ushtrimeve praktike të tilla si debate simuluese, sesione të zhvillimit të strategjive dhe ushtrime komunikimi për të rritur aftësinë e tyre në mbrojtjen e çështjeve rinore brenda komuniteteve të tyre.

3. **ACTive Bootcamp** do të jetë një program trajnimi intensiv dy-ditor, i përqendruar në zhvillimin e aftësive praktike të avokimit, negociatave dhe udhëheqjes për pjesëmarrësit. Ky bootcamp synon t'u japë pjesëmarrësve mundësinë për të praktikuar dhe për të fituar përvojë të drejtpërdrejtë në zbatimin e këtyre aftësive për të ndikuar në mënyrë efektive politikën dhe proceset vendimmarrëse.

Vendndodhja

Bashkia Maliq, Sarandë, Tepelenë dhe Gjirokastrë

Periudha e ofrimit të ekspertizës

4 muaj, Nëntor 2024-Shkurt 2025

Kohëzgjatja e Angazhimit

6 ditë pune

Objektivat:

- Përgatitja e materialeve, hartimi dhe mbajtja e trajnimeve;
- Zhvillimi i aftësive të lidershit, të dialogut publik dhe të avokimit të anëtarëve të këshillave rinor;
- Sigurimi i përvojës praktike përmes ushtrimeve simuluese për të zbatuar aftësitë e mësuara;
- Përgatitja e anëtarëve të këshillave rinor për t'u angazhuar në mënyrë efektive në qeverisjen lokale, politikë-bërjen dhe avokimin brenda komuniteteve të tyre.

Përgjegjësitë kryesore:

Eksperti me mbështetjen e organizatës do të ketë detyrat e mëposhtme:

- **Hartimi dhe Përgatitja e Trajnimeve:**
 - Zhvillimi i materialeve trajnuese për analizën e politikave, strategjitë kombëtare dhe europiane për të rinjtë, avokimin dhe planifikimin strategjik;
 - Mbajtja e 1 trajnimi 2 ditorë dhe angazhimi i pjesëmarrësve përmes përdorimit të metodave ndërvepruese si rastet studimore, diskutimet në grup dhe ndarja e roleve;
 - Nxitja e të menduarit strategjik - pajisja e të rinjve me aftësitë për të analizuar politikat dhe për të zhvilluar perspektiva strategjike në nivel lokal, duke rritur kapacitetin e tyre për nxitjen e iniciativave të lidhura me rininë;
 - Trajnimi i pjesëmarrësve nepërmjet metodave efektive të komunikimit për të artikuluar dhe avokuar për çështjet e të rinjve në mënyrë të qartë dhe bindëse.
- **Organizimi dhe përgatitja e ACTIVE Bootcamp:**
 - Lehtësimi i ushtrimeve simuluese për zhvillimin e aftësive praktike të avokimit, përvojën praktike në zbatimin e aftësive të avokimit, udhëheqjes dhe negociimit.
 - Trajnimi i pjesëmarrësve përsa i përket teknikave të negociatave, duke i nxitur ata të zhvillojnë aftësinë për t'u angazhuar në vendimmarrje dhe për të ndikuar në mënyrë efektive politikat.
- **Raportimi dhe dokumentacioni:**
 - Përditësim i rregullt pranë stafit të Përtej Barrierave dhe një raport përfundimtar mbi trajnimet dhe Bootcamp-in duke përfshirë rezultatet kryesore dhe rekomandimet.

Kriteret për kualifikim

- Diplomë e avancuar në shkencat politike, shkencat sociale ose fusha të ngjashme;
- Të paktën 3 vjet përvojë në trajnimin e të rinjve, zhvillimin e lidershit ose avokimin;
- Njohuri të thella mbi politikat rinore dhe planifikimin strategjik në nivel lokal dhe kombëtar;
- Njohuri mbi mekanizmat dhe strategjitë e avokimit dhe mundësitë për angazhimin e të rinjve në procese vendimmarrëse;
- Ekspertizë në lehtësimin, hartimin e trajnimeve dhe ofrimin e seminareve për të rinjtë;
- Eksperiencë në analizën e politikave, strategjitë e komunikimit dhe të dialogut publik;
- Aftësi të shkëlqyera ndërpersonale dhe komunikuese;
- Njohuri të gjuhës angleze.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Jetëshkrim (CV)



- Letër interesi
- Ofertë financiare [Link](#)

Procedura e Vlerësimit

Zgjedhja e ekspertëve do të bazohet në: se sa mirë aplikimi përmbush kërkesat e përcaktuara në termat e referencës.

*Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë çdo aplikim brenda datës **05 Tetor 2024**, në adresën elektronike: office@beyondbarriers.org*

**Ju lutem konsideroni që vetëm kandidatët fitues do të kontaktohen.*